



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
REKTORATI  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1413 prot.

Tiranë, më 10.11 .2021

URDHËR

Nr. 159 , datë 09/11/2021

MBI

**“ FILLIMIN E PRANIMEVE TE APLIKIMEVE, NGA ANA E FAKULTETEVE TË  
UART, PER STUDENTËT TË CILËT PËRFITOJNË PËRJASHTIM OSE  
REDUKTIM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT, PËR VITIN AKADEMIK  
2021-2022, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” (i ndryshuar); Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë” dhe në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 27, datë 29.12.2017 për “Strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë,

URDHËROJ:

1. Fillimin e pranimeve të aplikimeve, nga ana e Fakulteteve të Universitetit të Arteve, për studentët të cilët përfitojnë përjashtim ose reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2021-2022.
2. Personat përgjegjës që do të merren me administrimin e procesit në çdo Fakultet, janë si më poshtë:
  - Nermin Zebi (Fakulteti i Muzikës) - nermin\_zebi@yahoo.com;
  - Arta Dashi (Fakulteti i Arteve të Bukura) – arta\_dashi@yahoo.com;
  - Enela Mastori (Fakulteti i Artit Skenik) - enelamastori@yahoo.com
3. Studentët duhet të dorëzojnë aplikimet/formularin si dhe gjithë dokumentacionin provues fizikisht dhe në e-mail e personave të përcaktuar në pikën 2.
4. Grupi i punës ka për detyrë të shqyrtojë dokumentacionin sipas kriterëve të përcaktuara në Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 269, datë 29.03.2017 “Për





përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” (i ndryshuar) dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë”, (formulari bashkëngjitur), publikuar ëeb-in e UART.

5. Afati përfundimtar për dorëzimin e dokumentacionit, në zyrën e protokollit në Rektorat nga Grupi i Punës është data 06 Dhjetor 2021.
6. Personat përgjegjës i regjistrojnë aplikimet e studentëve në një regjistër të veçantë dhe pasi shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga studentët, përcaktojnë studentët që përfitojnë ose jo nga përjashtim apo reduktim nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2021-2022. Materiali i përgatitur duhet të dërgohet Administratores së UART dhe Sektorit Juridik për verifikim brenda datës 10.12.2021.
7. Pas verifikimit të dokumentacionit të Grupit të Punës nga Sektori Juridik, përgatitet Informacioni për Administratorin e Universitetit të Arteve
8. Në çdo rast, kur një student aplikant paraqet dokumentacion/formularin, për përjashtimin/reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2021 - 2022, që në të ardhmen rezultojnë jo ligjorë, përgjegjësia bije mbi studentin i cili do të penalizohet.
9. Ky urdhër të shpallet në faqen zyrtare të ëeb-it, të Universitetit të Arteve dhe të afishohet në ambientet e Fakulteteve të UART.
10. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, zyra e Protokollit në UART, personat përgjegjës në çdo Fakultet dhe sekretaritë e Fakulteteve për njoftimin dhe shpalljen e këtij urdhri.

**Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë**

**Prof. Kastriot ÇAUSHI**

**REKTOR  
UNIVERSITETI I ARTEVE**

